

## LEKSIKONI I VENDBANIMEVE TË KOSOVËS, I-II-III, FQ. 2.023, PROMOVIMI, 17.03.2021

### Fjala e Kryeredaktorit, Hivzi ISLAMI

Pas një pune disavjeçare të një ekipi të madh bashkëpunëtorësh dhe specialistësh nga fusha të ndryshme, kryesisht nga shkencat gjeohapësinore, përfundoi me sukses projekti “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës – Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale”. Doli në dritë botimi i tij në tre vëllime. Vëllimet I-II tashmë janë përfunduar në mjediset e Akademisë, në prani të bashkëpunëtorëve të projektit, anëtarëve të Akademisë, punonjësve të shkencës, të kulturës dhe të interesuarve të tjerë. Ndërsa sot po e përurojmë edhe vëllimin III dhe gjithë kompletin. Vëllimi I përfshin 13 qendra urbane dhe 24 seli komunale, të mbarështruara dhe sistemuara sipas madhësisë territoriale-demografike dhe rëndësisë funksionale në gjithsej 553 faqe, Vëllimi II përfshin 737 vendbanime rurale, të prezantuara sipas alfabetit, nga shkronja A-LL, me gjithsej 730 faqe, ndërsa Vëllimi III nga shkronja M-ZH përfshin 694 vendbanime rurale me gjithsej 733 faqe. Kompletin kapë gjithsej 2.023 faqe.

Në realizimin e projekteve të tilla, përveç traditës dhe eksperiencës, si parakusht janë faktorët organizim, dije dhe mjete financiare. Traditë të gjatë në këto ndërmarrje të mëdha Kosova nuk ka, veçanërisht në hartimin e veprave kolektive të karakterit shkencor-enciklopedik. Puna në hartimin e Enciklopedisë së Jugosllavisë nga fillimi i viteve të 70-ta, me seli në Zagreb, ku ishte logjistika, kuadrot, mjetet etj. nuk mund të thuhet se ka krijuar një traditë. Kanë dalë dy botime në shqip të EJ, i treti ka mbetur në shtyp. Por as puna në hartimin e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar në Tiranë nuk ka krijuar ndonjë përvojë institucionale, sepse edhe këtu selia dhe logjistika ishin jashtë Kosovës, ndërsa angazhimi i autorëve nga Kosova ishte në nivel individual. Vetëm me Monografinë Kosova dhe Fjalorin Enciklopedik të Kosovës si paraprijës për hartimin e Enciklopedisë së Kosovës dhe më vonë, kur do të krijoheshin kushtet, edhe të Enciklopedisë Shqiptare, u pa se edhe institucionet e Kosovës mund të kenë sukses në hartimin e veprave kolektive-ekipore, çfarë janë monografitë shkencore, fjalorët enciklopedikë, fjalorët leksikografikë, fjalorët etimologjikë, leksikonet, enciklopeditë etj. Dëshmi e këtij fakti është edhe hartimi i **Leksikonit të vendbanimeve urbane dhe rurale të Kosovës**.

Tre vëllimet për vendbanimet e Kosovës përmbajnë të dhëna, fakte dhe informata relevante nga terreni, dokumentacioni dhe dijet për dimensionin fizik-hapësinor, demografik, funksional, historik, kulturor, ekonomik, gjeopolitik, infrastrukturor, pastaj të dhëna për dhunën, krimet, masakrat dhe dëmet materiale që i shkaktoi

regjimi fashisoid e gjenocidal i Serbisë etj. Të dhënat burimore dhe origjinale shkencore-enciklopedike për evolucionin cilësor dhe sasior të vendbanimeve të Kosovës janë si thuhet nga “dora e parë”, pra të vjela “në popull” përmes udhëzuesit-pyetësorit, me 50 pyetje e shumë nënpyetje. Të gjitha së bashku mundësuan ndërtimin e tablosë së vërtetë të krijimit, të dinamikës së jetës dhe të rrjedhave zhvillimore të vendbanimeve urbane dhe rurale, të kaluarën dhe të sotmen e tyre. U mbajtën dhe disa Work shope (Punëtori) në të cilat u diskutuan të gjitha çështjet relevante të punës në mbledhjen dhe mbarshtrimin e të dhënave dhe fakteve nga fusha të ndryshme.

Tekstet janë autoriale dhe disa sish, për shkak të materies shumëdimensionale dhe vjelës të lëndës, hartues të teksteve janë deri tre e katër autorë. Bashkëpunëtorët janë kryesisht nga territoret dhe vendbanimet që u përkasin dhe i njohin rrethanat konkrete dhe tablonë e gjithmbarshme të vendbanimeve. Bashkëpunëtorët janë të shumtën kuadro me grada shkencore që punojnë dhe veprojnë në institucione të ndryshme shkencore, arsimore, kulturore dhe publike, në nivel lokal dhe Republikan, gjithnjë nën udhëheqjen e redaksisë së projektit. Tekstet e autorëve domosdoshmërisht kanë kaluar nëpër disa redaktuara të ekspertëve; janë rishikuar, korrigjuar e plotësuar nga redaktorët dr. Ibrahim Ramadani, dr. Valbon Bytyçi dhe dr. Arsim Ejupi. Në fund tekstet e të gjitha zërave, për t’iu përshtatur modelit të publikimit brenda kriterëve të vendosura shkencore-enciklopedike, i redaktoi dhe i harmonizoi kryeredaktori i botimit për aq sa qe e mundur. Pa punën e bashkëpunëtorëve dhe në veçanti të redaktorëve Ramadani, Bytyçi dhe Ejupi vështirë se do të realizohej projekti hulumtues dhe zor se do ta shihte dritën botimi në këtë formë dhe cilësi.

Në të tri fazat e punës doli si problem në vete grumbullimi i të dhënave në vendbanimet rurale në komunat e Veriut të Kosovës, por edhe në komunat në jug të lumit Ibër, të banuara me popullatë shumicë serbe dhe të administruara nga serbët. U penguan nga autoritetet serbe bashkëpunëtorët e nacionalitetit boshnjak që u angazhuan për punë në terren në veri të Kosovës. Prandaj, bashkëpunëtorët tanë, veçanërisht dr. Arsim Ejupi, të shumtën janë detyruar t’i mbledhin të dhënat nga literatura, burimet dhe dokumentacioni serb. Jemi të vetëdijshëm se mund të ketë mangësi në gjithëpërfshirjen e të dhënave dhe fakteve fizike-hapësinore, populative dhe funksionale për vendbanimet rurale në këto pjesë të Republikës së Kosovës.

Projekti sjellë risi edhe në qasjen hartuese-metodologjike, duke iu shmangur skemës dhe karakterit klasik antropogjeografik. Qasja bashkëkohore teorike-metodologjike konsiston në përfshirjen e vështimit interaktiv të ekzistimit dhe veprimit të elementëve dhe faktorëve të ndryshëm natyrorë, shoqërorë dhe regjionalë që ndikojnë në baraspeshën e brendshme dhe karakteristikat fizike-hapësinore,

strukturën morfologjike, transformimet funksionale, pozitën në rrjetin e vendbanimeve etj. Pjesa tekstuale e botimit përcillet me material ilustrues, çfarë janë fotot për objekte të ndryshme gjeohapësinore, të trashëgimisë natyrore e kulturore dhe elementet fizionomike e funksionale etj., i cili e bënë më të kuptueshme materien e trajtuar brenda publikimit.

Me daljen në dritë të tre vëllimeve do të pasurohet fondi i të dhënave dhe fakteve për gjeoshkencat, dijet sociale, pushtetin lokal dhe opinionin profesional e të gjerë, pastaj do të krijohet databaza e të dhënave shkencore që do të shërbejë për hulumtimet e mëvonshme, të hollësishme të vendbanimeve, për tipet, funksionet, sistemin, rrjetin, zgjerimin hapësinor-fizik dhe rritjen demografike të tyre etj., sikundër dhe për qëllime aplikative të drejtpërdrejta apo të tërthorta: për planifikimin hapësinor, urbanistik dhe shoqëror, pastaj për motivet dhe potencialet turistike, për statistikën dhe administratën etj. Të dhënat që përmban Leksikoni janë një paralajmërues se para syve tanë po ndodhë braktisja e pakontrolluar dhe shpopullimi intensiv i fshatrave si pasojë e faktorëve repulsivë dhe rrjedhimisht reduktimi i riprodhimit (rënia e normës së lindshmërisë) dhe zvogëlimi i shtimit natyror dhe i rritjes së përgjithshme të popullsisë. Prandaj, ndërmarrja e masave dhe zbatimi i disa politikave komplekse për parandalimin e këtyre fenomeneve dhe proceseve negative është i pashtyeshëm.

Meqenëse për herë të parë realizohet një ndërmarrje e tillë, redaksia është e vetëdijshme se Leksikoni i vendbanimeve në tre vëllime që po e përurojmë sot e që po i ofrohet opinionit mund të ketë zbrazëti eventuale, prandaj redaksia pret nga opinionin profesional dhe opinionin i gjerë që të japin vërejtje dhe sugjerime të dobishme dhe konstruktive në mënyrë që në ribotimin eventual të merren parasysh dhe të plotësohen.

Botimi që e kemi sot në dorë, me inventarin e plotë fiziko-gjeografik, demografik, historik, kulturor, ekonomik, gjeopolitik etj., pa dyshim do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues dhe do të jetë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.

Në emër të Redaksisë i falënderoj Seksionin e Shkencave Shoqërore, që e pranoi projektin ideor dhe hyrjen në këtë projekt afatmesëm me tri faza të punës, Kryesinë dhe Kuvendin e Akademisë për mbështetjen institucionale dhe financiare që i dhanë realizimit të gjithë projektit, i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët për punën e bërë me përgjegjësi dhe redaktorët Ibrahim, Valboni dhe Arsimi, pastaj recensentët akad. Anton K. Berishajn dhe dr. Qerim Kastratin, lektorin Shefqet Rizën, sikundër që redaksia u është mirënjohëse të gjitha instancave të qendrave komunale dhe

bashkësive lokale, ofiqarëve, drejtorive të arsimit, të urbanizmit, të kadastrit etj. që u ofruan hulumtuesve dhe studiuesve tanë qasje në dokumentacion, në biblioteka dhe në terren.

Ju faleminderit!